

MOS MË URONI UDHË TË MBARË

ADEM ZAPLLUZHA

MOS MË URONI UDHË TË MBARË

Redaktor:
Agron Shele

Recensent:
Agron Shele

Lektor:
Veli Veliu

Piktura në ballinë :

Besim Lutolli - Beci

ADEM ZAPLLUZH

MOS MË URONI UDHË TË MBARË

Shtëpia botuese
TRENDI
Prishtinë 2019

Kur sytë e të nesërmes kapërcejnë përmes traditës dhe të shkuarës art Poeti Adem Zapluzha padyshim që është një nga figurat më komplekse të poezisë bashkëkohore sot në letrat shqipe, dhe kjo jo vetëm për aureolën e gjerë dhe gjithë tematikën përshkuese të artit të tij, por për vetë zanafillën krijuese që ka prekur tërë zhanret dhe pasqyrimin koherent të gjithë modalitetit jetë. I unisuar me ndërgjegjen kohë, tashmë nuk mund të kuptohen më kufijtë se ku fillon dhe mbaron arti i tij, krahasuar me gjithë botën përjetuese që rrethon, pleksur dhe mbetur aty, tek një atdhe që lundron shekujt deri sa dielli të ndriçoj përmbi dhe, e atij populli që madhështinë e udhëtimit të tij e ka kaluar përmes kalvarit dhimbje dhe gjakut si gjurmëjetë dhe sprovë të martirizimit për komb dhe flamur. Që në titull autori Zapluzha bën një antitezë, e cila në retrospektivë do shndërrohej simbolikisht “Tungjatjeta”, sepse e pashtershme është muza dhe fryma krijuese, sepse e pashtershme është vala e Drinit që lind në krojet e zanave, dhe epike do të thosha për ato maja të kreshpëruara malesh që zënë fill gjer në re. Po çfarë ka dashur poeti të sjellë përmes vëllimit të tij më të ri poetik?

Leximi i vëllimit poetik dhe format e vargëzimit të lirë, të cilat herë si transmetim i dhimbjes, për atë çfarë hijëzohet kontureve paskohë, herë si transmetim i ardhur nga përtejshpirtrat, si shëmbëlltyrë dhe depërtim në pamundësinë e qenies, herë si një regëtimë që udhëton përmes mijëra viteve, ose ndërthurjes përmes antikës dhe modernes, të fut në atë qerthull dhe intrigon përmes kuptimeve dhe mesazhit të përcjellë. Hermetizmi poetik si formë shprehjeje, por dhe dimension i dualizmit shpirtëror i autorit vjen si stilistikë për të hedhur gjysmëdritën dhe ndriçuar atë mendësi, e cila përherë endet në konfuzion dhe përherë ndjek shtigje të skajshme drejt përnjohjes dhe identifikimit si arsye dhe përsosmëri. Shëtitjet e poetit në paskohë, thinjave të lashta kohë, bëmave të burrave të mëdhenj, natyralizimit të shpirtit një me natyrën janë elemente që rritin fuqinë shprehëse dhe intrigojnë lexuesin për të kuptuar kufijtë e mendimit, por dhe relativizuar idetë që përshkojnë veprën letrare, si një përvojë krijuese, ideim dhe shenjë përjetësie në atë rrugëtim të qenësisë arsye. Për më tepër le të ndalemi në disa poezi dhe të kuptojmë më mirë metafizikën e

vargjeve, por dhe artin poetik në tërësi si formë dhe përmbajtje:

“Nuk dija se kush isha dje e kush jam sot
Nëpër fijet e thinjura të flokëve
Si ujëvarë dhembjeje
Derdhej një trishtim i pazakontë
Derdhej nëpër lëkurën time të zeshktë”

Dje dhe sot, një udhëtim mistik që kapërcen pa ndalur si ujëvarë dhembje dhe kreshpërim thinjash, trishtimit të pazakontë për atë çfarë ka kaluar dhe ka lënë gjurmë të thella, por dhe si shëmbëlltyrë dhe përpjekje për t’u çliruar, që e nesërmja të jetë ndryshe, por dhe të ketë për pikë nisje zanafillën e cila identifikon rrugëtimin e pandalshëm të një memorie jetësore, që është e gatshme të ardhmen ta ngrejë përherë të shkuarës së saj. Në aspektin filozofik do thosha se dyshimi i krijuar përmes atyre shtjellave që rrethojnë dhe konfuzionit që shpesh bëhet diskurs i një mendësie në raport me vetveten, nuk është as më pak dhe as më shumë, përveç se një refleksioni që shpirtëzohet gjer në nëndje dhe mbetet si abrogim i një nënlëkure, që sa herë ta gërvishtësh po aq herë do pulsojë

përtejndjesitë dhe përtejkonceptet që vlojnë memories kohë.

“Dielli ka pak shpresë
Që mund ta ngrohë njëherësh
Mbarë njerëzimin
Diku dikush ndoshta fshihet
Në ndonjë shtrojerë të akullt
Ku s’ mund të depërtojnë rrezet e tij”

Këtu patetizohet shpirti i poetit si mishërimi i dritës me shpresën, gëzimit të hareshëm ku shndrit dielli, për një botë më të bardhë dhe shumë më të ndriçuar, larg shtrojës akull dhe përherë blerimit jetë. Është jo vetëm dëshirë por dhe mision i një poeti, që të ngrejë kolorit ngjyrash mbi harqet e grishta, të mbjellë shpresë dhe dëshirë, për më shumë harmoni por dhe kuptimësi, për atë çfarë përfaqëson dhe atë që duhet të udhëheqë një njeri. Vëllimi më i ri poetik i autorit Zaplluzha është një tjetër prurje dhe risi në botën e artit të shkruar, pasi ngjyrat e hedhura nga kjo penelat, ndriçojnë dhe më shumë misticizmin e një udhëtimi që s’ di të ndalet, por shkruan të pashkruarën dhe ridimensionon të ardhmen më sy nga e shkuara. Agron Shele, shkrimtar, poet

Cikli i parë
Aty do gjesh zërin e lahutës

KA PASUR RASTE KUR KËNDONIN EDHE TË VDEKURIT

Ka pasur raste
Kur i kam prekur gjymtyrët
Nga ashti im pikonte koha
Pikonte një dhembje e trishtuar
Sa që zanat e malit nuk e ndalnin vajin

Ju thashë se ka pasur raste
Kur qielli binte në tokë
E toka si një lubi çohet në qiell
Ka pasur edhe raste më të liga
Kur nuk isha në gjindeje t'i njoh gjymtyrët

Nuk dija se kush isha dje e kush jam sot
Nëpër fijet e thinjura të flokëve
Si ujëvarë dhembjeje
Derdhej një trishtim i pazakontë
Derdhej nëpër lëkurën time të zeshktë

Ka pasur edhe raste të shthurura në jetë
Kur e harroja emrin tim
Ekzistenca më dukej
Si kokrra e pjekur e fasules
Ka pasur raste kur këndonin edhe të vdekurit

MUND TË JETË EDHE SI NË VJESHTË

Ky shi i hidhur
I kristaltë
Që po bie mbi thinjat e viteve
Duket aq qesharak
Sa që po më hidhet ta pështyj qiellin

Më duket pakëz i turbullt
Si Drini i bardhë në pranverë
Mund të jetë edhe si në vjeshtë
Kjo stinë e çmendur
Po i shkul rrënjët e gurëve

Sot kam tepër dhembje koke
Nga sytë e lodhur
Pikojnë qepallat
Kush i shkuli mbrëmë pemët
Sa që rrënjët dënesin pa pra

Asgjë më nuk jam në gjendje
Të kuptoj
I kam harruar të gjitha burimet e lumenjve
Po qajnë gurët e bardhë
Kurrë nuk jam takuar
Me një dënesje kaq prekëse

VUANIN NGA ETHET E ZEZA

Disa thonë se ishte marsi
E disa të tjerë pohojnë të kundërtën
Nuk ishte as marsi e as prilli
Ishin përzier muajt
Ishin përzier
Si kapelat e grisura të kufomave

Një fyell i kishte humbur kumbimet
As nuk qante
E as nuk këndonte
Jehu i gjetheve u shëmbëllente
Kallinjve të thekrës së djegur
Ose grunajave pa as një kokërr nëpër kallinj

Shelgjishtet qëndronin kacule mbi një gur
Qëndronin duke u mbështetur
Rrënjëve të një ulliri plak
Kurse stinët e egra
Vuanin nga ethet e zeza
Vuanin si gjarpri në shkretëtirë

NJË STUHI E PASHPIRT

Kur e pamë zhdukjen e eklipsit
Hëna ishte lakuriqe
Cip cullak
Ngjante me një foshnje
Të posa lindur

Qielli dukej i trentë
Fije mendjeje
Nuk i kishte mbetur në kokë
Nga xhepat e grisura
I shkundte të gjitha trishtimet

Yjet e verbër në pikë të ditës
Kishin mbetur pa itinerar
Dukeshin si zogjtë klandestinë
Një stuhi e pashpirt
I shkundte mjegullat mbi kokën time tullace

KËNDONTE NJË SERENATË ATË NATË

Të thërras bërtas
E këlthas
Ti nuk më dëgjon
Nga sytë e tua të kaltra
Pikon errësira

Një tjetër diell i ri
Po lind në hapësirë
Perëndimi i penduar
Harroi lojën e tij të vjetër
Kur u rrënuan themelet e Trojës

Helena as që kishte ekzistuar
Një mall i pashuar
I kishte ndezur qirinjtë
Në mendjen e një të dashuruari
Sa që trilloi një bukuroshe

Trilloi diçka
Që kurrë nuk kishte ekzistuar
Dhe filloj të dashuroj vdekjen
Një yll rebel
Këndonte një serenatë
Gjatë tërë kohës atë natë

Prishtinë, 1 dhjetor 2018

NËPËR LEDHET E HISTORISË

Në këto kohëra të liga
Bie një pëllumb në mesditë
Dhe mbrëmja nuk çohet në këmbë
Ushejzat e zeza
Thithin si me pompa gjakun e njeriut

Hëna e sfilitur diku në galaktikë
E ka humbur itinerarin
Nuk di ose nuk ka se ku të shkojë
Nëpër ledhet e historisë
Po ndryshojnë drejtimet e udhëtimeve

Nuk di më se ku jam
Dhe në cilin drejtim do të nisem nesër
Më ka ngecur sharra në gozhdë
Njerëzit më nuk janë ata që ishin dikur
Paskan ndryshuar ose janë konvertuar në djaj

PO RRËSHQASIN DITËT

Sonte duart e mia
Po u shëmbëllejnë statujave
Janë të ftohta
Pa shpirt
Vetëm një stuhi e fortë mund t'i zgjojë
Ëndrrat e pa ëndërruara

Në oborr lehje qensh
Nuk pushojnë
As cerberët e së kaluarës
Çdo gjë sonte
Po leh trishtueshëm në mua
Po lehin edhe muret e akullta

Më duket se nuk më ka mbetur
Më kohë
Po rrëshqasin ditët
Po rrëshqasin si ushejzat
Nëpër gjakun tim të turbullt
Nga shekujt lavire që më shkelën

NË SHUPLAKAT E HAPËSIRËS SË PAFUND

S'do të thotë se bota
Po fundoset në fundin e pafund
Ka kohë për kataklizmin
E fundosjes së fundit

Yjet janë shumë larg
Prej meje
Po aq edhe sa janë afër

Ky perëndim i diellit
Po i shëmbëllen xixëllonjave
Që notojnë në një tas konserve

Dielli si një patate e nxjerr
Nga prushi
Është duke pjekur lëkurën time
Po e pjek tokën e zhuritur
Në shuplakat e hapësirës së pafund

Më duket se ishte koha e shirave
Por asnjë rigë e hollë
Nuk ia behe te portat e Parajsës
Thua se kishte vendosur
Të derdhej diku bile edhe përtej Ferrit

PLEQTË THOSHIN ISHTE KOHA E ARMËVE

Jashtë oborrit tim
Dëgjohet zëri i vrazhdë i klerikut
Nga minarja
Ose kambana e vjetër
Për herë të parë fluturuan
Zogjtë e trilluar të mendimeve

Më duket se ishte një stinë e acartë
Bora përdridhej si shtëllunga
Nëpër flokët e thinjura të plakave
Ishte po ajo stinë e viteve
Njëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë
Kur për herë të parë pamë borën e kuqe

Mbase u skuq nga gjaku i njerëzve
Ishte po ajo kohë
Kur për një pushkë vriteshin shtatë vetë
Pleqtë thoshin ishte koha e armëve
Pasi që nga frika
Vriteshin edhe të pafajshmit

TROKITE NË DYERT E TOKËS

Mëngjesi ose ishte mbrëmja
Kishim humbur ndjenjën për orientim
Nëpër udhët e kalldrëmta
Pamë skelete kuajsh
Dhe kufoma të djegura njerëzish

Ishte një kohë e rëndë për sy
Po ashtu edhe për veshë
Hingëllimat e kuajve u ngjanin
Vajeve të foshnjave
Lufta nuk ishte as në fund e as në fillim

Pemët lëviznin si hijet e zeza
Makthet e degëve
Zgjoheshin shumë herët
E binin vonë
Për të mos ndryshuar itinerarin e ngjarjeve

Një njeri me një bastun të vjetër
Trokite në dyert e tokës
Trokite si i çmendur
Mbi varret e vithisura
Trokite në ndërgegjen e njerëzimit

NUK KISHA RASTISUR TË SHOH

Ishte një kohë e keqe
Na i vranë kuajt nëpër kopshte
Vetëm kali i drurit ai i vëllait tim
Hingëllonte nëpër lagje
Mbase donte
Me ua prishur gjumin njerëzve
Nga letargjia e rëndë e vdekjes

Nga të katër anët e udhëve
Derdheshin ushtarët e huaj
Derdheshin me vdekje nëpër trasta
Ne shikonim nga të çarat e dyerve
Shikonim se si zbrazej qyteti
Nga një dëbim i paparë deri atë ditë

Kur mbërrimë te stacioni i pikëllimit
Nëpër binarë
Pashë ca pika loti
Dënosa edhe unë se kurrë më parë
Nuk kisha rastisur të shoh
Se me çfarë trishtimi qajnë traversat

ÇFARË MUND TË THOTË NJERIU

Ende nuk di përse ndodhën ato pamje
Por i çova duart lartë
Kah qielli
I çova në drejtim të yjeve
Dhe e derdha hirin tim

Diku mes ajrit dhe tokës
Mbiu një asht
I cili dukej si pema e jetës
Mbase mbiu edhe fjala
Dhe tmerrësisht kundërshtoi dhunën

Traversat e kalbura para shumë viteve
Nuk thënë asnjë fjalë
As nuk reagues
E as nuk kundërshtuan
Shikonin si të mpita dëbimin shtazarak

Çfarë mund të thotë njeriu
Kur nuk ka të bëjë me njerëz
Ndonjëherë i mungon forca shpirtërore
Heshtë si një përmendore e ngrirë
S'thotë asnjë fjalë mbase janë të kota fjalët

Ikën edhe zogjtë
Nuk kanë më vend se ku të ulen
I prenë rrapet e fshatit
Deri në rrënjë i prenë
Selvitë
Asnjë pëllumb i egër s'ka ku të ulet

THONË SE ISHTE DIMËR

Notojnë nëpër dhembjet e Drinit
Ca duaj talle
Notojnë edhe kufoma njerëzish
Të nakatosura
Një stuhi çnjerëzore
I shfarosi deri në rrënjë grunajat

Atë mbrëmje dielli kishte perënduar
Shumë më herët
Nëpër degët e djegura të plepave
Ishin fshehur gjinkallat
Asnjë njeri nëpër xhade
Nuk dukej në ato çaste të trishtuara

Thonë se ishte dimri izi
Një acar që kafshonte shpirtra
Vetëm varkë e vetmuar
Me shtatë rrema
U doli zot duajve
Që notonin nëpër çmendinë e dallgëve

HERË LEHNIN E HERË MJAULLONIN

Nuk kishte vend ku të ulej
Përpos
Në pragun e gurtë
Plaka rrinte kacule dhe i shikonte
Dykrenorët e drunjtë
Që s'kishin forcë të fluturonin

Një erë e fortë i ngacmonte
Këndesat e metaltë
I ngacmonte nëpër çatitë e rrënuara
Shiu ende nuk kishte mbërritur
Por meteorologët
Kishin paraparë një rrebesh të stuhishëm

Nëpër mëhallët e braktisura
Asnjë njeri nuk duket
Vetëm macet dhe qentë
Herë lehnin e herë mjaullinin
Tani më në gjuhën e tyre të njohur
Atë natë ndjemë peshën e urrejtjes

KJO STINË E RIGAVE

Kur përmyten lisat
Dallgët shpërthejnë nga rrethi i nëntë
Vetëm dy varka të vjetra
Me nostalgji
Kujtojnë të kaluarën e hidhur

Era u bie daulleve të skamjes
Brigjet në heshtje dënesin
Kurse Drini krenar
Kishte mbetur nëpër istikame
Dhe shikonte se si vazhdonte preja

Nuk shoh më njerëz këndeje pari
Ikën me trenin e çmendur
Të një marsi
Ikën ose u dëbuan nga cerberët
Zogjtë e fundi të qytetit

Kjo stinë e rigave
Po na i gris të gjitha kujtimet
Nuk di më se ku na mbetën flamujt
E luftës por gjithsesi
Djemuria i doli zot etërve të dëbuar

MË DUKET SE KISHIN VDEKUR EDHE PEMËT

Nuk dimë ku na mbetën kuajt
Flamujt e dizgjinët
Na i rrëmbeu armiku
Nuk na mbeti asnjë shteg i hapur
Të dalim tej matanë bregut

Udhëve pamë kocka gjedhësh
Deleve të ngordhura
Ua kishin hequr maskat
Vetëm kërmat e gomarëve
Kundërmonin erë vdekjeje

Diku në hapësirë i pamë
Se si fluturonin zogjtë e shpresës
Fluturonin ata të Atlantikut
Në drejtim të vareve të etërve
Fluturonin pëllumbat e metaltë të paqes

Kaluan ditët dhe muajt
Vdekjet i numëronim me gishtat e duarve
Dhe të këmbëve
Më dukej se kishin vdekur edhe pemët
As gjelbërimi më nuk merrte frymë

NËPËR ERRËSIRËN E DENDUR

Dikush të vrarët i quajti
Kufoma
Koçan të ngrirë në stuhi
Flamuj të mbetur nëpër manaferra
Të grisura dhe të djegura

Ecte kolona nëpër natë
Nga sytë e errësirës pikonte trishtimi
Nëpër hendeqe
Pamë edhe kuaj të ngordhur
Dukeshin si flamujt e luftës

Nuk di a thua vallë desha të bërtas
Ose të këlthas
Që zëri të më dëgjohet
Edhe përtej shtatë palë qiejve
Këto pamje dukeshin si fantazma biblike

Nëpër errësirën e dendur
Ende po fjollon nga pak bora e skuqur
Sytë e mekur të kolonës nuk bëzanin
S'duket asnjë dritë në fund të tunelit
Një errësirë e lig tej përtej
Ma shpon ballin e ngrirë

SEPSE ATËHERË E NDJEJA AROMËN E BARIT

Më duket se erdhi çasti
I ndarjes
Mund të jetë edhe i takimit
Por gjithsesi
Diçka do përjetojmë në duet

Do jetë një lloj e pashpjegueshme
Si një halucinacion
Që i shëmbëllen eklipsit
Kur sterra takohet më hënë
Në puthjen e brigjeve të kujtesës

Unë kurrë nuk isha i ftuar
Në dasmën e të klonuarve
Gjithmonë fluturoja pas kosheres
Më pëlqenin luadhet
Sepse atëherë e ndjeja aromën e barit

Ndarjet dhe takimet
Janë aq të ngjashme njëra me tjetrën
Sa që njeriu
Kurrë nuk e kupton ndarjen
Ose takimin me vetveten

TË MOS JEM NJERI

Ndonjëherë sa më mundon harresa
Po aq më mundon
Edhe kujtesa
Në luadh për çdo ditë shohë
Lopën tonë të larme
Dhe të zotin e lopës
Që na lë katër stinë pa qumësht

Shoh dhe s'kam se çfarë t'i bëj
Një hije e verdhë
Si gur mermeri qëndron
Mbi kokën time
Ose në ndërgjegjen e tij
Por gjithsesi
Është një hije e rëndë mizore

Lopa e bardhë bardhoshja
Dhe ajo e kuqja kuqaloshja
Nuk e njohin armiqtë
Ah sa kisha dashur vetëm njëherë në jetë
Të mos jem njeri
E t'i harroj njëherë e përgjithmonë
Armiqësitë që ma rëndojnë kokën

KUR VDES BARIU NËSE VDES

Kur vdes bariu
Delet e përcjellin deri në varr
Me blegërima të trishtuara
Përcjellin qivurin
Në të cilin dëgjohen britmat
Dhe të lehurat e qenve

Ju thashë se kur vdes bariu
Vdesin edhe kullosat
Të nesërmen vjen një tjetër bari
I cili në vend të ogçit
Aty për aty shndërrohet
Në një përcjellës më besnik

Kur vdes bariu nëse vdes
Tufa e dhenve
I afrohet përroit të zi
Dhe me padurim pret
Kërcimin e deles së parë
Pret të takohen në fund të greminës

ATY DO E GJESH ZËRIN E LAHUTËS

Kur hynë nëse hynë
Në palcën e legjendës
Pyeti mermerët e kuq të Kosovës
Pyeti se përse janë skuqur

Mos u friko
Zbrit nga baladat
Ose kalëro te eposet e pa kënduara
Vetëm në brendinë e atyre këngëve
Do e gjesh historinë e maskuar të një populli

Unë eca dhe jam duke ecur
Mbi dymijë tremijë vite
Dhe kurrë askund nuk e takova
Fillin e baladave shqiptare
Nuk i takova as legjendat që lindën nga guri

Dil ose hyrë në shpirtin e tokës
Vetëm ajo nuk e tretë amanetin
Nëse s'ke besim ose guxim
Bëri zë Kostandinit
Sa ora Doriu çapkën do jetë pranë teje

Dil edhe nga baladat po deshe
Të mos mbytesh në brendinë e tyre
Gërmo nën tokën e shkriftë të Dardanisë
Aty do e gjesh kumbimin e lahutës
Dhe fillet e të gjitha këngëve epike
Prishtinë 2 dhjetor 2018

NJERËZ PREJ GOME DHE METALI

Nuk di më kujt t'i besoj
Predikuesit
Ose rrufjanët
Nëpër rrugë takoj klerik
Dhe njerëz që s'i besojnë as vetvetes

Ecim në drejtime të kundërta
Shpeshherë
Kundër rrymimit të ujit
Ose të erës
Dhe mbesin të gozhduar si miza
Në mëkatin e vet

Shoh njerëz me maska të zeza
Dhe me ato të bardha
Por gjithsesi janë maska
Nëpër fytyra
Me disa lloje pamjesh teatrale

Çfarë nuk parakalojnë trotuareve
Duke i imituar kukullat
Njerëz prej gome dhe metali
Me hundë
Që marrin frymë
Nga të shtatë vrimat e kavallit

PO ASHTU EDHE NË AKTIN E FUNDIT

Ky dru i mykur
Dhe bari i venitur
Për çudi
Duken si pantomima e vdekur

Kam parë në jetë
Pamje edhe më të këqija
Deri në katër akte
Por kjo e sotmja i tejkalon të gjitha

Unë nuk di në cilin akt
I lashë duart e sfilitura
Ky shikim i lodhur
M'i ka dërmuar në tërësi ndjenjat

Si na aktin e parë
Po ashtu edhe në atë të fundit
I dëgjoja me durim të pashoq
Britmat e trishtuara Hamletjane

Cikli i dytë
Ato nëna të mira me zjarr në sy

DEL PËRBALLË VETVETES

Vonë shumë vonë kuptova
Se njeriu
Në të shumtën e rasteve
Nuk vajton personin që ka vdekur
Por mjerisht qanë vetveten

Në secilin lot të derdhur
Ngrit si dollinë
Për pikëllimin e çastit
Dhe të rastit
Kur manifeston dhimbjen inferiore

Më duket se nga këto raste
Ndjen lumturi
Kur loti i imagjinuar
I del përballë vetvetes
Dhe qeshë se si mund të qaj njeriu si kali

NJË HUTIN I MOSHUAR

Më sa mësova në jetë
Mësova të dëgjoj në heshtje
Se si hingëllon
Kali i dehur kur dënes gjelbërimi

Nga sytë e fluturave të kaltra
Fluturojnë ose linden
Rrezet e para të diellit
Në anën e kundërt të lindjes

Ju thashë se kur kuptova
Ishte tepër vonë
Aq vonë
Sa që e humba trenin e fundit atë ditë

Të gjithë qeshën ose më mirë me thënë
U zgërdheshën me mua
Një hutin i moshuar
Nën pemën e kujtesës i shkundte pendlat

LOZIN EDHE MYSHQET

Një gjeth i zverdhur dhe i acartë
Gjinkalla dhe era
Mbi telat e ndryshkura të telegrafit
Lozin tangon e fundit
Në tehun e stinës mistike

Lart nga malet zbresin ose dëgjoen
Zërat e të gjitha llojeve
Të drurëve të mërdhirë
Rrënjët janë strukur
Diku thellë në ëndrrën e dimrit

Sërish dëgjoen disa lloje të zërave
Ai zë bariton i kabanës
I paska harruar të dielat
Dhe me një, pantomimë të përsosur
Bisedon me shtrëngatën e ngrirë

Buzë Lumëbardhit të dremitur
Një lojë madhështore e algave
Nuk pranë asnjë çast
Lozin edhe myshqet
Një valle të stërlashtë pagane

OSE AI QË KISHTE KOKË PREJ BUNGU

Shfletoj gazetën ditore
Pamje të plumbta
Mes kronikave të zeza
Dhe ato mistere të bulevardeve
Që ta çojnë krupën

Një hënë prej porcelani
Thyer në shtatëdhjetë e shtatë pjesë
Duket kurrë më e shëmtuar
Në këto çaste
Të tërbimit të mjegullave

Ndale o hyj dorën
Ndale të mos çmenden yjet prej plastike
Ky shi jo i zakonshëm
Po pështynë me mllef pa pra
Nëpër ollukët e kujtesës

Nuk di sa por ishin shumë dasmorë
Që mbetën te rrapet
Mbetën duke pritur njëri – tjetrin
Se cili do lëshoj rrugë
Ose ai që kishte kokë prej bingu
Prishtinë , 3 dhjetor 2018

ATO NËNA TË MIRA ME ZJARR NË SY

Dal në bregun e majtë të kujtesës
Shikoj nënat
Ato nëna të mira me zjarr në sy
Shikoj kah përkundin djepat
E bijve të bijve të etërve tanë

Shikoj kah kalojnë kalldrëmeve
Tërmalet e tatëpjetë
Duke ecur ngarkuar me djepa
Që janë gdhendur nga rrapi shekullor
Ato nëna të mira me zjarr në sy

Shikoj dhe mallëngjehem
Me të djeshmen
Duke ëndërruar të nesërmen
Duke ëndërruar mbi një kalë të bardhë
Si dëborën e Alpeve tona krenare

Ja pra përse i dua brigjet e kujtesës
Mi përkujtojnë ato nuse
Nëna të mira që lindën djem
Me këmishë të hekurt
Që as plumbi s' mundi t'i shitojë

KRAKËLLIMA E TRISHTUAR PUSHOI

Ishte një heshtje e madhe
Më pastaj
Dëgjuam disa të trokitura
Të pakontrolluara
Më duket se dëgjova
Si në një ëndërr të keqe
Dëgjova krakëllimën e korbit të Edgarit

Sërish një heshtje varri
Zëri i ndryshkur i teneqes
Dëgjohej në errësirën
Gjysmë të vdekur
Dëgjohej
Një zë vrazhdësie
Mbi syprinën e xhamave të palara

Dhe sërish po ajo heshtje
I rrihte qepenat e thyera prej viteve
Nëpër rrugë
Vetëm lehjet dhe mjaullimat
Kalojnë në drejtim të tërmales
Krakëllima e trishtuar pushoi
Pushuan edhe zërat e zogjve

KËPUCËT NA MBETËN DIKU NË FILLIM

Sot po më duket se është errësuar dielli
Nuk shoh asgjë përtej hunde
Nga gishtat e mi të verbër
Pikon balsami i vdekur
Për hiç gjë
Në shtatëqind pjesë
E grisëm të vetmin jorganin që e patëm

Gjithmonë mendonim se jemi dikush
Kurrë nuk kuptuam
Se asnjë njeri nuk banon
Në qenien tonë
Jemi të zbrazët si kungulli i kalbur
Vetëm farat mbase përpëlitën
Si disa gjallesa në rropullitë e sëmura

Kur filluam të ecim
Kaluam nëpër një rrugë të stërgjatë
Kaluam e nuk mbërrimë askund
Secili prej nesh
Dështoi që në hapin e parë
Këpucët na mbetën diku në fillim
Dhe kurrë më nuk arritëm ta shohim fundin

NË DAÇ QAJ DERI NË AMSHIM

S'kapërdihet dot kjo vetmi
Kjo kockë e fortë
Që thyen dhëmb e dhëmballë
Plaga që nuk njeh dot shërim
Si shpata e Demokleut
Më lëvaret mbi kokë
Për çdo ditë çdo javë e mot

Çfarë nuk pashë në jetë
Kuaj të vetmuar
Që qanin
Më shumë se njerëzit
Drurët nëpër male
Vuanin nga kjo sëmundje e vërtetë

Këtë plagë vetëm shpirti i vetmuar
Mund ta mbaj
Se në të kundërtën
I fundos malet dhe detet
Në daç këndo
E në daç qaj deri në amshim
Vetmisë dot s'do i gjesh shërim

MBI KAMBANOREN E KISHËS SË VJETËR

Preke ajrin e tendosur
Preke si telin e këputur të kitarës
Do kuptosh se në zërin e saj
Janë fshehur të gjitha zërat
E të gjallëve dhe të vdekurve

Më kujtohet kur ishte këtu dimri
Në secilin hap
Ndjenim frymëmarrjen e ngricës
Acari jetonte sot për nesër
Duke pritur ardhjen e beharit

Zogjtë disi dukeshin më të lumtur
Me gishtat e saja të holla
Mëngjesi prekte telin e pestë
Të kujtesës
Prekte gurgullimën e përroit

Ne mbetëm me duart e shtrira
Kah itinerari i kthimit të stinës
Ktheheshin edhe shtërgjet
Mbi kambanoren e kishës së vjetër
Mjegullat luanin vallen e shiut

POR JA QË PËR FAT TË KEQ

Në qytetin tim të Lidhjes
Kam parë shira
Dhe zogj të verbër

Kam parë duke fluturuar
Në drejtim të mjegullave
Speciet
E të gjitha llojeve të shpendëve

Fluturonin edhe gurtë e varreve
Njëri që kishte vdekur
Para dyqind
E më shimë viteve

Kishte lënë të shkruar një epitaf
Thonë se
Ai njeri e donte jetën
Po aq sa e kishte dashuruar poezinë

Por ja që për fat të keq
Njeriu gjithmonë tradhtohet
Së pari e lë poezia
Pastaj pas saj ikën edhe jeta

Jeta e cila pas shumë viteve
Shndërrohet në një gur të murrmë
E cila nesër do të duket
Si një epitaf i palexuar

I ZOTI I SHTËPISË KTHEHET NË ITAKË

Jam ndalur te pragu
Mbi dyert e mëdha të drunjta
Si dy perëndi të pavdekshëm
Qëndrojnë të gdhendura
Dy zogj gjigantë
Qëndrojnë dykrenorët e atdheut tim

Shikojnë përreth avllisë
Në të katër anët e vendit
Sa me krenari i lëvizin krahët
Shikojnë dhe nuk mejnë krakëllimat
Një yll në qiellin e paanë
Herë kyçet e herë shkyçet

Në shpirtin e dallgëve të tërbuara
Çmendej deti
Të cilit iu rritej malli për liri
Papritur u ndezën yjet në kupën e qiellit
Një anije e lashtë me qindra rrema
I paska kyçur qirinjtë e shpresës

I zoti i shtëpisë kthehet në Itakë
Kthehet si i huaji
Në vatrën ku me vite nuk u ndez zjarri
Vetëm qeni besnik e njohu
Kurse cerberët shumë më herët
Kishin mpreh dhëmb e dhëmballë

MBASE NUK KISHTE NEVOJË PËR TO

Ishte një gjysmë krisme
Mbase dhe na u duk
Si gjysmë zëri
Por gjithsesi
Ishte një si zë kambane

Në oborr të kishës
Mejtën të gjitha psalmet
Muret më kurrë nuk kënduan
Ishte një kohë e shthurur
Ku çdo gjë përgjysmohej

Stoli ku uleshin plakat
Për t'i festuar kërshëndellat
Qëndronte mbi dy gjysmë këmbë
Lëvizte ngadalë
Si ndonjë oktopod i plagosur

Kleriku i moshuar
I kishte humbur ose braktisur
Të gjitha rruazat
Tani më s' kishte nevojë për to
Në vend të tyre përdorte celularin

ISHTE NJË FLUTURIM I PAPRITUR

Nuk më ka qëlluar
Asnjë mollë në dorë
Diçka edhe më e çuditshme
Po ngjanë me mua
Nuk di se kur u zgjova
Ose zogjtë u zgjuan para meje

Një pëllumb i larmë
Fluturoi diku larg mes yjeve
Ose në çerdhen e ndonjë copë mjegulle
Por gjithsesi
Ishte një fluturim i papritur
Nëpër plagët e qiellit të nakatosur

Disa të huaj çuditërisht
Nuk dinin të bënin kryq
Ndoshta në vendin e tyre
Në vend të kryqit të gurtë
Luteshin totemeve
Prej drurit të abanozit të egër

VETËM MJEGULLAT IA ZËNIN FRYMËN

Ndoshta më dukej vetëm mua
Se kuajt ishin prej bronzi
Por dalloheshin disi pakëz më tepër
Çuditërisht i kishin edhe
Hingëllimat e bronzta

Ja pra ky kalë i larmë
Dinte të qeshte
Po edhe të qante
Vetëm atë ditë për herë të parë kuptova
Se kuajt dinë të qajnë si njerëzit

Një shalë e vjetër
Dhe një palë dizgjin prej rripi
Dikush i huaji i kishte varur
Për gjuhën e hënës
Dhe aty qëndronin si njeriu i flijuar

Retë kishin një pamje të plumbtë
Atë ditë nuk binte shi
Vetëm mjegullat ia zënin frymën
Drurëve që mezi mbaheshin në këmbë
Ishin trungje drurësh gjysmë të djegur

KUR MBETEM VETËM

Kur mbetem vetëm
Nuk jam në gjendje t' i kontrolloj
Pjesët e gjymtyrëve
Nofullat lëvizin
Thua se donë ta kafshojnë qiellin

Kur mbetem vetëm
Gishtat dridhen ngadalë
Ose humbin kontrollin e gjykimit
Shikoj lartësinë e qiellit
Yjet pikojnë si shirat e vjeshtës

Kur mbes vetëm atëherë desha ose jo
Kuptoj se vetmia qenka vrastare
I shtrij duart kah hapësirat
E vdekura
Mbase kuptoj se duart si paskam të gjalla

Kur mbetem vetëm
Nuk kam më nevojë as për vetveten
Sytë dhe gishtat rrotullohen ngadalë
Rrotullohen në anën e kundër të erës
Kur mbetem vetëm
Sa trishtueshëm më ngufat vetmia

I DOJA LULET KUR QESHNIN

Ishin kohërat ku me ngjyrat
E ylberit ngjyrosja ëndrrën
Nga secila rreze ultraviolete
Me një gjeth dafine
Thurja kurorën më të bukur dashurisë

I doja lulet kur qeshnin
Po ashtu edhe kur qanin
Ishin lule
Të virgjëra me një aromë të posaçëm
Për shqisat tona delikate

Çfarë nuk doja në kohën time
Rinia ishte alfa dhe omega
Bota që sillej përreth saj
Fyelli magjik
Si shpirti i erës mes luleve të çelura

OSE PËR FATIN E GJELBËRIMIT

Prej rigave të imta të shiut
Fshihesha prapa fjalëve
Në dorë mbaja një zambak
Aromën e të cilit se kuptonte askush
Sepse njerëzit
Pa menduar fare instinktivisht
I drejtojnë sytë kah bukuria

Më kujtohet kur në adoleshencë
I kositnim luadhet
Një bletë qante mbi një trëndafil
Nuk di a thua vallë
Qante për barin
Ose fatin e gjelbërimit
Që rrafshohej me tokë si ushtari i vdekur

Sërish po ju them
Se nuk fshihesha asnjëherë
Nga rigat e imta të shiut
Por kisha droje nga fjalët e mia
Dhe fshehja ishte e vetmja mënyrë
Për ta shpëtuar kokën
Nga thimthat e bletëve të konvertuara

PO ASHTU EDHE BORA BINTE E PËRDREDHUR

Gjithmonë vijnë me stinët
Rigat e para të shiut
Ose bora përdridhej nëpër skuta
Sa që i trembte zogjtë e fëmijërisë

Mbrëmë na zbritën mjegullat
Erdhën edhe rrufetë
Erdhën me shkrepimat e egra
Sa që na i këputën dizgjinët e kuajve

Ndonjëherë dal në korije
Dhe i dëgjoj ninullat e fëmijërisë
Sa bukur këndonin etërit në lahutë
Rapsoditë e kohërave të lashta

Kur rigon ose bie borë
Më duket se po afrohen stinët
Si pranvera po ashtu edhe dimri
Ulen dhe këndojnë në telat e kujtesës

Sivjet rigoi një shi pakëz më ndryshe
Po ashtu edhe bora binte e përdredhur
Origjinal në mënyrën e saj
Se që të dyja stinët kënduan në duet

PËR T'UA LËNË NIPËRVE AMANETIN

Ai gjithmonë rri aty te pragu
Me një lahutë të vjetër ku e presin
Te korijet zogjtë e fëmijërisë
Rri dhe këndon në lahutën e etërve
I këndon këngët
Që kurrë s'janë dëgjuar deri më sot

Pleqtë thonë se nuk ndahet asnjëherë
Nga telat e ndryshkur të lahutës
Përpos këngës
Nuk pati asnjë njeri në jetë
Këndoi dhe vajtoi në duet
Me dhe për etërit e tij të vdekur

Për mrekulli i njeh varret
Mbi secilin gur varri ka mbjellë
Nga një këngë të vjetër
Dhe testament të ri
Për t'ua lënë nipërve amanetin
Të cilin as toka nuk e tretë

Prishtinë, 4 dhjetor 2018

SE VETËM ATËHERË

Më jepni një rrap
Të ua mësoj qëndresën lisave
Afër dymijë vjet
Bëra hije mbi tokën tonë krenare

Më jepni një trëndafil të kuq
Të ia ndryshoj ngjyrën ylberit
Nëse duhet edhe detit
Do ia huazoj kaltërsinë

Më jepni një fjalë e cila
Mund ta çoj në këmbë lirinë
Se vetëm atëherë
Mund të quhemi njerëz të lirë

Më jep një fije force
Ta ndryshoj hartën e botës
Se vetëm atëherë
Njerëzimi mund të flasë për lirinë

KURSE NGA KËMISHËT TONA

Krejtësisht befaz
U paraqit eklipsi i kujtesës
Ne nuk ishim askund
Kur përjetuam në duet
Tërmetin e adoleshencës

Ti i shëmbëlleje lules
Asnjë petale nuk të mbeti
Në degët e brishta të gjymtyrëve
Atë çast ti ishe alfa
Kurse mua nuk më ngjante të jem omega

Një drithërim i muskujve
I lëvizi damarët e ballit nga rrënja
Para nesh dolën zërat e së kaluarës
Etërit me nga një bastun
Trokitnin mbi tokën tonë të dërmuar

Dhe ne ecëm pa ditur se ku
Dhe kur do të mbërrimë në atdhe
Udhët ishin të gjata
Kurse ne nga këmishët tona
Shtrydhnim gjakun anemik të shekullit

NË ZBRAZËTINË E ZBRAZËT TË KORRIDORIT

Brenda katër mureve të korridorit
Një tryezë e kafshuar nga molat
Dhe pasqyra gjysmë e thyer
Pa e llogarit vetveten
Askush në këtë hapësirë
Që ta zë frymën

Më duket se te rafti i thyer
Lëvizi një mushkonjë
Ka kohë që asnjë libër nuk palosej
Në brendinë e pluhurit
Mbase nuk kishte mbetur asnjë njeri
T'i shfletoj kronikat e vjetra

Më duket se s'kishte mbetur
Asnjë hartë
Një dorë tinëzare i kishte zhdukur
Tok me dokumentet familjare
As Bibla në anën perëndimore të dhomës
E as Kur-ani në anën lindore s'ishin në raft

Në zbrazëtinë e zbrazët të korridorit
Tryeza e vjetër
Dhe pasqyra gjysmë e thyer
Ëndërrojnë kohërat e mira

NGRITE ZËRIN TËND PREJ BUBULLIME

Një britmë njeriu dëgjohej në korije
Po ashtu edhe një zë baritoni
Po ai i etërve
Që na zgjoi nga gjumi
Kur atdheu kishte nevojë për ne

U zgjuam dhe si titanët
E legjendave
Ua mësymë armiqve
Ua mësymë sa që nuk kishin guxim
Të bëjnë as dy hapa për të ikur

Shtatë ose tetë herë i dëgjuam gjëmat
E Drinit të Bardhë
S'pushuan as piskamat e burrave
Fëmijët lindnin të gjymtuar
Ose i shkullnin nga barqet e nënave

Jo njeriu por as bisha nuk ka shpirt
T'i shikoj këto pamje të masakrave
Oh Zot nëse ekziston diku në qiell
Ngrite zërin tënd prej bubullime
Ose lëshoje grushtin mbi kokat e barbarëve

GATUAN ME NJË DASHURI TË MADHE

Ndoshta ajo nënë e madhe
Nga pështyma e saj
Filloi të gatuj një njeri
Njëqind vjet gatoi
Si bukën e përditshmërisë
Gatoi njeriun i cili flinte te rrapet

Më së pari filloi nga zemra
Më pastaj doli te sytë dhe ndjenjat
Nga toka e etërve të saj
Por gjithsesi
Ajo gatuante njeriun
Për një të nesërme që do lindte

Po ashtu filluan edhe nënat e tjera
Natë e ditë të gatuanin
Gatuanin me ngrrohtësinë e lotëve
Jetën e përditshmërisë
Fëmijë prej dheut të shkriftë të Kosovës
Gatuan me një dashuri të madhe
Dashurinë e njerëzimit për njerëzimin

AFROHEJ DITA E GJYKIMIT

Ne pamë me trishtim
Pamë se si fundosej era
Në grykën e kraterit
Toka ndjente se kishte zjarrmi
Ndjente se si e përvëlonin damarët

Një vijë e hollë uji
Si curril gjaku
Derdhej nëpër përroin e djajve
Derdhej nga kujtesa
Ajo plagë që kurrë nuk u shërua

Në shtratin e djersitur
Pas nëntë vjetëve i kishte zënë gjumi
Eshtrat e thyera
Por bajlozi i zi kurrë nuk u gëzua
Edhe në gjumë i frikohej Gjergjit

Kurse jashtë nën pemët shtatzëna
Hingëllonte një kalë i bardhë
Hingëllonin edhe rrënjët e shqetësuar
Afrohej dita e gjykimit
Shën Mëria veç e kishte dhënë bekimin

ANDAJ QESHNIM NJË KOHË TË GJATË

Kjo heshtje e mbrëmjes
Paska ngjyrë dhe shije të metaltë
Këndesat nëpër çati
Mbi njëqind vite
Po e presin shiun i cili s'erdhi asnjëherë

Nuk them kot se na shurdhon kjo heshtje
Nuk bëzajnë as teneqet e ndryshkura
Një tjetër diell i dogji kujtimet
Kur si fëmijë
Provonim të krijojmë disa lloje muralesh

Më besoni nuk na pengonte
As shiu monoton
Nëpër varre lexonim disa lloje epitafesh
Sa që kishte edhe asi qesharake
Për disa lloje vdekjesh pa lidhje

Ndoshta neve na dukeshin të tilla
Por epitafi si epitaf
Nuk na tregonte asgjë siç duhet
Andaj qeshnim një kohë të gjatë
Me marrëzitë njerëzore

NUK U SHËMBËLLENIN USHTARËVE SY ÇAKËRDISUR

Ishte një luftë e trishtuar
Trenat na dukeshin si përbindësja gjigant
Një nënë afër një kaçube
Kishte harruar një fëmijë
Njomëzaku qante deri në kupë të qiellit

Ushtarët me bajoneta të gatshëm
Për ta përmbysur dynjanë
Kishin urdhra të prera
Asnjë shqiptar të gjallë
Nuk duam të shohim në Prishtinë

Kurse qyteti zbrazej në heshtje
Zbrazej si një kazan
I shpuar nga automatikët
Tok me fërshëllimën e trenit
Nuk prante as vaji i foshnjës te kaçuba

Binarët dhe ushtarët e dehur
Këndonin një këngë monotone
Kishte edhe ushtarë të përlotur
Por të tillë ishin shumë të rrallë
Nuk u shëmbëllenin ushtarëve sy çakërdisur

OSE NËNAT QË I KISHIN GRISUR SHAMITË

Ja se si dukej tragjedia
E jonë shqiptare
Na ngujuan në një fushë të vdekur
Prej një atdheu të vrarë
Na dëbuan në atdheun tjetër të robëruar

Na dëbuan atje ku nënat
Gatuanin bukë prej lotëve
Si mund t’i themi kësaj atdhe
Ku një tjetër polici me ushtari të çmendur
I kishin djegur traversat

Rrotat e trenit të mbushur me njerëz
Ma përkujtojnë anijen “fantazmë”
Nga e cila nënat shqiptare
I gjuanin foshnjat në det
I gjuanin të gjalla në ujin e kripur
Të mos vdesin nga uria

Nuk di a thua më shumë qante shiu
Ose nënat që i kishin grisur shamitë
I kishin grisur për t’i lidhur plagë
E pleqve të masakruar
Për t’i lidhur plagët e pashëruara të atdheut

SË PARI MALI E ZBUTI KALIN

Ky mal dhe ky kalë
Nuk paskan lidhje njëri me tjetrin
Sa herë që thithi aromën e luleve
Hingëllon sa që bien gjethet në tokë

Më thanë se fije gjelbërimi
Nuk ka mbetur në palcën e malit
Nuk i besova askujt
S'desha t'i besoj as kalit

Njerëzit edhe ashtu janë të sëmurë
Jetojnë prej thashethemeve
Kujt pra i duhet aroma e trëndafilin
Kur cofin kuajt nga një gjemb banal

Më ndjeni o njerëz
Së pari mali e zbuti kalin
Pastaj kali malin e egër mësoi të rritet
Kurse trëndafili mbeti peng për disa vjet
Prishtinë, 5 dhjetor 2018

Cikli i tretë
Mos më uroni udhë të mbarë

FRIKA

Kur jam i frikësuar
Si guaska e murrme mbyllem
Nën ndonjë guralec të imagjinuar
Mbyllem në vetvete
Mbyllem nga frika
Sepse nuk di t'i dalloj gjembat
E akullta të dallgëve të ngrira

Ulem nën ndonjë rrënjë
Të gjelbër të barit të egër
Dhe meditoj tërë kohën
Derisa më kalon frika
Më duket se
Kur janë të frikësuar njerëzit
Më së shumti frikohen për vetvetes

Shpeshherë i shpalosin kujtimet
E fëmijërisë
Ose nga baladat e lashta
Nxjerrin pësimet
Ose ndonjë mësim por gjithsesi
Frika kurrë nuk u ndihmoi atyre
Që jetuan dhe jetojnë me frikën

DIELLI KA PAK SHPRESË

Thonë se ne mërgimtarët
Dhurojmë nga një kafshatë bukë
Dhurojmë të uriturve
Një copë shprese
Që të mos i shtrinë duart e ngrira
Kah fytyrat e të huajve

Dielli ka pak shpresë
Që mund ta ngrohë njëherësh
Mbarë njerëzimin
Diku dikush ndoshta fshihet
Në ndonjë shtrojerë të akullt
Ku s' mund të depërtojnë rrezet e diellit

Ani që ne presim kafshatën e mërgimit
Sërish jemi njerëz krenarë
Nuk gjunjëzohemi asnjëherë
Stuhitë i kemi miq
Kurse tufaneve
Gjithmonë ua kemi treguar dhëmbët

ASKUSH NUK E SHKUNDI DERI MË SOT

Ngadalë lëvizin degët e thata
Lëvizin si gjymtyrët e oktopodëve
Nën hijen e mështeknës
Qëndron ulur kacule ulliri i vjetër
Ndoshta është mbjellë
Në ndonjë betejë të Gjergjit

Rri mbështetur krenar
Mbi supet e kohës
Rri me një pallto të vjetër hedhur
Shpatullave të dërmuara
Dhe pret që nga kokrra e ullirit
Ta shtrydhin vajin e shpresës

Në prehrin e kopshtit të përgjumur
Me qindra rrënjë ullinjsh rriten
Rriten siç marrin shtat fëmijët
Një kokërr e verdhë
Paska mbetur në majat e degëve
Askush nuk e shkundi deri më sot

NUK DOLI ASNJË PERËNDI

Dy njerëz dhe një pasqyrë
Kalojnë rrugëve
Kalojnë me nga një pallto të përhitur
Kurse kalldrëmet e lashta ilire
Endin këmishën e Penelopës

Nënat përkundin djepa
Përkundin ku do rriten djemtë e Itakës
Herkuli një perëndi i pakurorëzuar
Që në fillim tregoi
Se nuk u lind si njeri i zakonshëm

Olimpi ishte aq i vogël
Sa që nuk pati vend për perënditë
Që me kohë filluan të ikin
Të largohen nëpër botë
Të shkojnë atje ku bukës i thonë bukë

Kur u ndezën zjarret
U ndezën edhe yjet në hapësirë
Nuk doli asnjë perëndi
I cili pati forcë t'i shkyçi dritat
Në shpirtrat e pavdekshme të yjeve

PREKIN PLAZMËN E KOHËS

Duke prekur me gishtat e holla
Ajrin e elektrizuar
Prekin të kaluarën dhe të ardhmen
Të verbëtit e lagjes sime
Si bebëzën e syrit
Prekin plazmën e kohës

Çfarë nuk prekin në ecjet e tyre
Mbi akullin e kristaltë
Prekin verën dhe vjeshtën
Por kurrë nuk harrojnë
Gishtat e tyre
Të cilat me sy e prekin dashurin

Duke ecur deri në theqafje
Nëpër litarin akrobatik
Prej teli
Njerëzit prekin të paprekurën
Atë ajër të tendosur
Si telin e pestë i kitarës

NGA GJAKU JUAJ I PRISHTË

Si lubitë dolët nga strofujt
E bishave
Në netët e sterrët dhe të acarta
Na e vodhët zjarrin
Nuk latë njeri mbi tokë

Kishat i konvertuat në djaj
Dhe na e rrëmbyet kryqin
Nuk patëm rast
Të marrim frymë
Na e zutë për gryke me errësirën e juaj

Ja se si sot përvetësuar lahutën
Në kumbimin e së cilës
Me shekuj kanë vajtuar zanat
Nga gjaku juaj i prishtë
Kanë vu kujë edhe nënat

ME NJË USHTË PREJ MISHI E GJAKU

Si një rrap mjekërbardhë
Qëndronte në pragun e drunjtë
Mbase ishte vjeshta e fundit
Shtreza si shiu i pranverës
Rigonte mbi flokët e thinjura të Pashait

Ulur mbi pragun e avllisë
Shikonte se si lulëzonte tradhtia
Mjekra dhe koka i dridheshin
Çfarë të bëjë ky gjigant
Si mund t'i vret fëmijët e vet

E vetmja motër që i kishte
Mbetur në vatër
Me një ushtë prej mishi e gjaku
Rinte përballë vdekjes
Duke e përbuzur tradhtinë

Më në fund e lëshuan këmbët
Ortekun që s'deshi të vdesë në këmbë
Pashai i madh i Janinës
Qeshte si Gryka e Këlcyrës
Qeshte me vallen e turpshme të vdekjes

NGA KËTO LINDJE HOMERIANE

Që nga kohërat e britmave
U lindën Homerët
Nëpër grykat e maleve dhe detet
Kalonin anijet me qindra rrema

Lindte një diell i ri
Nga kumbimi i lahutës u lindën kreshnikët
Dynjaja e morri të mbarën
U lindën edhe Homerët

I kapërcyem të gjitha Iliadat
Nga zëri bariton i atdheut
Lindnin zjarret
Lindnin për t'i djegur djajtë

Nga këto lindje Homeriane
Kurrë më nuk mejtën patërshanat
Të gjithë ama tërë dynjaja
Aq shumë e deshi këtë tokë gratçore

HIJET E MURRME SI ME NJË VELLO ZIE

Në qiellin e hapur mbase edhe të mërrolur
Në pamjen e parë
Duket sheshazi një lojë madhështore
Yjet lozin tangon e shiut
Kurse rigat e imta
Si në ndonjë legjendë
Ndriçojnë hapësirën e paanë

Nga rrënjët e ullinjve
Buron një muzikë
Tepër e trishtuar
E cila i shëmbëllen pantomimës
Nënat me shamia të bardha
Heqin vallen e zanave
Alpet shqiptare qajnë dhe dënesin

Dënesin si pegunët pa fole
Kur dikush ua vjedh zërin
Tingujt e hajnisë dëgjohen larg
Ose janë shurdhuar njerëzit
Hijet e murrme si me një vello zie
I kanë mbuluar shkrepat
Dhe doket burrërore të Alpeve

PO IKIN SI DJALLI PREJ TEMJANIT

Nuk di kujt t'i besoj
Vetëm pikave të shiut imcak
Kisha besim
Kujt tjetër t'i besoj
Në këtë kohë të cerberëve

Nëna ime nuk është më
Shkoi pas një shiu
E cila kurrë më nuk u kthye
Me ua pastrua pluhurin
Ikonave në murin përballë pasqyrës

Pas saj iku edhe babai
Në moshë të shtyrë mbeta bonjak
Lagjja më dukej më e varfër
Se asnjëherë më parë
Nuk më përcillte as më prite dikush

Mbase u mësove me vdekjen
Filluan të vdesin
Të gjithë një nga një
Më duket se po ikin prej meje
Po ikin si djalli prej temjanit

SE DO TË SHKOJNË DIKU

Lëre që iknin njerëzit
Por dikur vonë
Filluan të largohen edhe fluturat
Luadhet mbetën të shkreta
Asnjë zëzëllimë blete
S' dëgjohej në shpirtin e gjelbërimit

Në fund të arës të moçalishnja
Siç thoshim ne
Në çdo pragstinë
Mund të dëgjonim
Vetëm korin e bretkosave
Dhe zërin madhështor të shiut

Nëna dhe babai im krenar
Nuk ishin askund
Mbase kishin ikur në botën tjetër
Gjithmonë më thoshin
Se do të shkojnë diku
Ku me padurim i pret farefisi

SËRISH EDHE SONTE

Nuk dua të gjykoj
Ose të paragjykoj dikë
Por kurrë nuk mësova prej askujt
Se si duket Zoti
Më duket se nuk di
Se si duket hija ime kur perëndon dielli

Një hënë me shi për çdo natë
Vjen tek unë
Vjen dhe bisedojmë si dy adoleshent
Për të kaluarën
Dhe për të ardhmen
E cila asnjëherë s'paralajmëroi ardhjen

Sërish edhe sonte
Kjo hënë lozonjare
Po luan me mua si macja me miun
Loja e cila gjithmonë ripërsëritet
Vetëm kur bie shi
Nga flokët e shprishura të hënës

AS QË DO TË PUSHOJNË NDONJËHERË

Mos thuaj se do të kthehesh
Ti edhe ashtu
Kurrë nuk erdhe me shtërgjet
Në çdo pragpranverë
Kam pritur dhe përcjellë fluturat e kaltra

Mos të lutem mos më thuaj dy herë
Se do të kthehesh
Po të kishe menduar për kthimin
Kurrë nuk do ikje
Me lejlekët në fundstinë

Shirat e egra kanë mbërri tok me acarin
Dyndjet e zogjve
Edhe sivjet nuk pushuan
As që do të pushojnë ndonjëherë
Unë do shndërrohem në përmendore
Prishtinë, 6 dhjetor 2018

RRITEN EDHE DHIMBJET E PLAGËVE

Mbrëmje e llahtarshme
Avulli i dendur ua zë frymën mureve
Ikona pranë pasqyrës
Nuk ndalet duke u kollitur
Një pluhur i verdhë i ka mbuluar muret

Heshtja lodron si pela e egër
Nëpër korridorin e mykur
Dritaret e mbyllura s' marrin frymë
E tërë kjo pamje
Tmerrësisht i shëmbëllen udhës së golgotës

Pas kopshtit statujat prej bronzi
U janë mbështetur pemëve
Një borë e imtë fjollon
Mbi degët e plakura të ullinjve
Mbase në pranverë s'do çelin asnjë lule

Nuk është hera e parë
Që në atdheun tim me vrizma dhembjesh
Përdridhen stinët
Rriten edhe dhembjet e plagëve
Gjergji në shtrat nuk i lëshon dizgjinët

DËGJONI GJËMËN E KËSAJ TOKE

Nuk di a thua vallë
U ndalëm ndonjëherë ta pyesim veten
Se çfarë bëmë për atdheun
Sa herë ja lidhëm plagët
Kur rënkonte në shtratin e Gjergjit

A thua kaq pak meritoi
Kjo tokë e etërve tanë krenarë
Që po ja kthejmë sot shpinën
Po e marrim dynjanë në sy
Pa menduar se kujt po ja lëmë atdheun

Mbase nesër as që do t'i gjejmë varret
E etërve të përvuajtur
Do i lërojnë siç kanë lëruar
Gjer më tani ujqërit e tërbuar
Do i asgjësojnë
Të mos mbetet askund nami as nishani

Koha është jo të largohemi
Por të kthehemi
T'i ripërtërimë varret dhe kryqet
Dëgjoni gjëmën e kësaj toke
Se si vajtojnë eshtrat e nëndheshme

S'MUND TA SHKULI ASNJË TUFAN

Ju nuk jeni duke parë
Se si po i fsheh duart e mia
Po i fsheh nga të dridhurat
Kurse ju keni mbetur
Ashtu siç ju kujtoj të rinj
Pa asnjë rrudhë nëpër mollëzat e juaja

Më besoni gjithmonë keni qenë të tillë
Djem të rinj
Bukuria e juaj antike
Sot vijëzohet në mendjen time
Ani që po më dridhen duart dhe koka
Por kujtesën time asgjë nuk e ka prekur

Ju thashë jeni të rinj keni forcë
Ta shkulni rrapin njëqind vjeçar
Mos ja vëni mendjen duarve të mia
Le të dridhen sa të donë
Por kujtesën për ju djemtë e mi
S'mund ta shkuli asnjë tufan

MOS MË URONI UDHË TË MBARË

Nëse dal nga lëkura ime
E marr udhë
Nga e cila nuk ka kthim prapa
Mos guxoni
Të bëheni miqtë e lotëve
Sepse burrat kurrë nuk qajnë

Këto fjalë s'janë fjalë amaneti
Por më se të singerta
Seç mund të jenë fjalët e tjera
Për jetën time të bujshme
Kurrë nuk jam penduar
Jetova gjithmonë ashtu siç desha

Përse pra lot dhembjeje
Mes këtyre mjegullnajave
Dielli për askënd nuk lind njësoj
Nëse dal për udhë
Mos më uroni udhë të mbarë
Sepse nuk dihet asnjëherë kësaj rruge
Do mbërri në Ferr ose në Parajsë

DOBIÇ NA DOLI LAHUTA

Mbani zi vajtoni nëna
Grithni fytyrat
Etërit e mi të pafat
Peni i lahutës më s'kumbon

Një gugash diku në ograja
As nuk qan më me trishtim
As nuk këndon

Një hije e zezë
Me dorë na e zuri qiellin
Ligjërisht UNESKO
Na e vodhën diellin

Në konakun tonë shekullor
Dobiç na doli lahuta
Ledheve mbeti shkretë eposi
Të dënesi nëpër grigje
Të vajtoj nëpër skuta

Më është dehur gjaku
S'di nga erdhët o ju të përroit
Në këto troje
As që dihet
Deri ku do të mbërrini
Kur Homerët e vërtetë
I binin lahutave
Ndryshe kumbonin këngët
Në mal e në vëri
I grishnin trimat në ballë të luftës
I grishnin kreshnikët për liri
Prishtinë, 7 dhjetor 2018

Adem Zaplluzha u lind më 1943 në Prizren, Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Një kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret kryesisht me poezi që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë të cilën e botoi në revistën “Pionieri”, më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës bashkë me shokët e punës dhe pendës themeloi grupin letrar “Lulëkuqet e Kosovës”. Në Kuadër të punës së këtij grupi letrar qe botuar përmbledhja “Ngjyra e kohës”, në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetatat e kohës që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në

librin Kosova letrare të poeteshës Monica Mureshan. Është prezantuar në Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990, nga Hasan Hasani, në Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 - 1995 nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin Portrete Shkrimtarësh nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002 Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe. Jeton dhe krijon në Prishtinë.

BOTIME TË AUTORIT

1. “Puthje”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë, 1974.
2. “Ecjet e viteve të mëdha”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. “Çamarrokët e Thepores”, poezi për fëmijë, “Shkëndija”, Prishtinë 1996.
4. “Muret”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997
5. “Morfolojia e dhembjes”, poezi, “Faik Konica”, Prishtinë, 2000
6. “Ai vjen nesër”, poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2007
7. “Letër nga mërgimi”, poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu” Kastriot, 2007
8. “Letër nga mërgimi 2 “ poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. “Udhëdarja”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
10. “Thirrje e gjakut”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu” Kastriot 2008
11. “Asgjë sikur molla”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. “Vesa në lotin tim”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,

13. “Puthja e gozhduar”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2009.
14. “Kashelasha në vargje”, poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2009.
15. “Pema e bekuar”, E përkthyer, Rumani, 2010.
16. “Bajraktarët e vatanit”, poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. “Hijet e ndryshkura”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
- 18.”Stuhi në Kutulishte”, poezi, ”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
19. “Posa ikte nata”, poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot, 2010.
20. “Loja e myshqeve”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
21. ”Lumëbardhi dhe gjëma”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010
22. “Metafora e heshtjes”, poezi, “Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010
23. ”Hyji në Prekaz”, poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot, 2010.
24. ”Sinorët e hinores”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot 2010.
25. ”Don Kishoti dhe Rosinanti”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010

26. "Zjarri i dashurisë", poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
27. "Kur likenet vallëzojnë", poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
28. "Ditari në vargje", poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
29. "Tingujt që nuk përfundojnë", poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010.
30. "Shtegu i mallit", poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
31. "Korniza e thyer", Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
32. "Zgjimi i gjëmës", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
33. "Vallja mistike", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
34. "Merre kodin", Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011
35. "Letër atdheut" poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
36. "Tejdukshmëria e shiut", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
37. "Përtej teje", poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
38. "Sa afër e sa larg", poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011
39. "Vallja e zanoreve", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011

40. “Ikja e eshtrave”, Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
41. “Kalorësit e mjegullave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
42. “Hingëllimat e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
43. “Kur pemët i ndërrojnë këmishët”. Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
44. “Mirëmëngjesi Imzot”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
45. “Kafshimi i mikut”, Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
46. “Atje tej maleve”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot, 2012
47. “Heshtja që del në shesh,” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
48. “Portat e shpresës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
49. “Në dhomën time gjysmë të errët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
50. “Kinse Lojë Shahu”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
51. “ Për çdo dekadë nga një baladë “, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
52. “Fusha e mëllenjave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
53. “E kujt është kjo vetmi”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

54. “Mos pyet për adresën e lumit”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
55. “Stoli në parkun vjetër” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
56. “Urori i stralltë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
57. “Po të mos ishte fjala”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
58. “Thyerja e urave”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
59. “Trokëllimat në gjumin e dallgëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
60. “Në flokët e dëborës”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
61. “Një grusht nostalgji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
62. “Kur filluan të flasin njerëzit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
63. “Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
64. “Lisi në rrënjët e veta”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012
65. “Eca ecëm dhe do ecim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
66. “Fëmijët e erës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012

67. “ Çast në fund të stinës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
68. “Si të flas me drurët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
69. “ Më pëlqejnë mendimet e tua”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
70. ”Andej dhe këndej kohës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
71. “Zëri i heshtjes”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
72. “Kush i lexoi letrat prej erës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
73. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”, prozë poetike, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
74. “Koha e ime dhe koha e jote”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
- 75.” Diku te një baladë”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
76. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
- 77 “ Ky def prej hëne”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
- 78.“Pyesni zogjtë në ikje ”,Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot 2013

- 79 “ Fërfërimë gjethesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
80. “Refrene yjesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
81. “Te delta e mjellmave”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
- 82.“Rinjohja”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
- 83.“Diku në fund të një fillimi”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
- 84.“Mëkati i hijes”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
- 85.“Një zog prej uji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
- 86.”Asnjë fjalë nuk frymon”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.
- 87.”Daullet e një nate”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
- 88.”Sytë e gurtë të erës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
- 89.”Kur dehen perënditë”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
90. “Fjetëm njëqind shekuj” Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.

91. "KraKëllimat e natës", Poezi, Shoqata e shkrimtarëve "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
92. "Ndjekësit e enigmave", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
93. "Atdheu i paçmuar" Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
94. "Psalm i harruar", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
95. "Për kë po bie moj kabanë", Poezi Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
96. "Mbi flokët e ullukëve", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
97. "Menatë vijnë lejlekë", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
98. "Loti i gotës së dehur", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
99. "Stina asnjënëse", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
100. "Dëneste bashkë me erën" Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
101. "Druri i pikëlluar", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
102. "Një grusht dashuri", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
103. "Lëreni zërin tim", poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014

104. “Shi në qytetin tim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
105. “Si trenat e verbër ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
106. “Zjarri i malli tim ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
107. “Kur teshtin era”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
108. “Mbi shpirtin e erës pagane”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
109. “Nëpër gjymtyrët e mjegullave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
- 110.”Ajo nuk erdhi sonte” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
- 111.”Një hënë e zhveshur”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
112. “Nëpër plasaritjet e mureve”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
- 113.”Mes telave gjembor ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” ,Prishtinë, 2015
114. “Të vizatosh një zog në mur”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
- 115.” Nuk flenë as kuajt e dehur” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
- 116.”Fluturojnë zogjtë e verbër ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015

117. “Një shi prej bryme” , Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND” , Prishtinë, 2015
118. “Në prehrin e pemëve” Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND” , Prishtinë, 2015
119. “Zëri i largët i shiut ”, Poezi
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
120. “Yjet e ngrira të kujtesës ” , Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
121. “ Thirrmat e hijeve”, Poezi, Shtëpia
Botuese”TREND”, Prishtinë, 2015
122. “Dritaret e verbëta ”, Poezi, Shtëpia
Botuese”TREND”, Prishtinë, 2015
- 123 . “Përtej portave të mbyllura” , Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
124. “Malli i etjes” Poezi, Shtëpia Botuese
“TREND”, Prishtinë, 2016
125. “Kur qajnë pemët ”, Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
126. “Të dielave në qytetin tim ”, Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
127. “ Njëpër brigjet e kujtesës” Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
128. “Rrugës qante një stërqok”, Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
129. “Kali im prej bore” , Poezi, Shtëpia
Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
130. “Përballë hijes së mollës ”, Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016

131. “Jehu i zërave”, Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
132. “Në kujtesën e pemëve ”, Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
- 133.“Më mirë një gjysmë ëndrrë ”, Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
- 134.“Një dry prej dylli ” Poezi, Shtëpia
Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016.
- 135.“ Në anën tjetër të mendjes”, Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
- 136.“Sa shumë ethe pat dimri sivjet”, Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
137. “Enigmat e kashelashave ”, Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
138. “Nuk i them unë dot kësaj liri” , Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
139. “Fluturat prej letre ”, Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
140. “Fluturimi i gjinkallës”, Poezi, Shtëpia
Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
- 141.“Kumritë prej deltime”, Poezi, Shtëpia
Botuese “TREND”, Prishtinë. 2016
- 142.“Më pritni te baladat e gurit”, poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2017.
- 143.“Trenat këtu gjithmonë vonohen”, Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
- 144.“Lulëzojnë gjethet e ullinjve”, poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2017

145. “Teatri antik i kujtesës”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
146. “Portreti i lirisë”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017
147. “Një stinë delikate”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017
148. “Te ullishtat e vjetra ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
149. “Ishim të lumtur si gjinkallat”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017
150. “Pikëllimet e rrënjëve”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
151. “Telat e shirave ” poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017
152. “Një stuhi prej bryme”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2018
153. “Sonte s’ka dashuri ” poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2018
154. “i shëmbëllente pluhurit kozmik”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2018
155. “Llamburite atdheu i plagosur” poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2018
156. “Gurët e pjekur shtatë herë” poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2018
157. “Kur të dalë nga kjo stinë” poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2018

158. “Ishin thyer te gjitha urat ” poezi,
Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2018
159. “Gjethi i këputur në vjeshtë ” poezi,
Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2018
160. “Ti mundesh nëse do” poezi, Shtëpia
Botuese TREND”, Prishtinë, 2018
161. “Pëllumbat prej rrufeve”, poezi, Shtëpia
Botuese TREND”, Prishtinë, 2018
162. “Diku në zbrazëtinë e ndërgegjes”,
poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë,
2018
163. “Retë e dendura të kujtesës ”, poezi,
Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2018
164. “ Pak diell e shumë acar”, poezi, Shtëpia
Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
165. “Kur kyçen yjet e harresës ”, poezi,
Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
166. “Nga pragjet e shtëpive”, poezi, Shtëpia
Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
167. “Fluturat e djegura ”, poezi, Shtëpia
Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
168. “Përtej asaj peme”, poezi,
Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
169. “ Kuajt e mjegullave”, poezi, Shtëpia
Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
170. “Po të ishte ndryshe ”, poezi,
Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
171. “Kur kthehen zogjtë e shiut ”, poezi,

- Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
172. “Mes gishtave të hijes”, poezi,
Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
173. “kush i theu xhamat e shiut”, poezi,
Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
174. “Poemat e dhembjekrenarisë ”, poezi,
Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
175. “Marsi i çmendur në dy kohës”, poezi,
Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
176. “ Kur dënesin varret”, poezi,
Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
177. “ Mos më uroni udhë të mbarë”, poezi,
Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019

PËRMBAJTJA:**Cikli i parë**

Aty do gjesh zërin e lahutës.....	9
Ka pasur raste kur këndonin edhe të vdekurit.....	11
Mund të jetë edhe si në vjeshtë.....	12
Vuanin nga ethet e zeza.....	13
Një stuhi e pashpirt.....	14
Këndonte një serenatë atë natë.....	15
Nëpër ledhet e historisë.....	16
Po rrëshqasin ditët.....	17
Në shuplakat e hapësirës së pafund.....	18
Pleqtë thoshin ishte koha e armëve.....	19
Trokite në dyert e tokës.....	20
Nuk kisha rastisur të shoh.....	21
Çfarë mund të thotë njeriu.....	22
Thonë se ishte dimër.....	24
Herë lehnin e herë mjaullinin.....	25
Kjo stinë e rigave.....	26
Më duket se kishin vdekur edhe pemët.....	27
Nëpër errësirën e dendur.....	28
Sepse atëherë e ndjeja aromën e barit.....	29
Të mos jem njeri.....	30
Kur vdes bariu nëse vdes	31
Aty do gjesh zërin e lahutës.....	32
Njerëz prej gome dhe metali.....	34
Po ashtu edhe në aktin e fundit.....	35

Cikli i dytë	
Ato nëna të mira me zjarr në sy.....	37
Del përballë vetvetes.....	39
Një hutin i moshuar.....	40
Lozin edhe myshqet.....	41
Ose ai që kishte kokë prej bungu.....	42
Ato nëna të mira me zjarr në sy.....	43
Krakëllima e trishtuar pushoi.....	44
Këpucët na mbetën diku në fillim.....	45
Në daç qaj deri në amshim.....	46
Mbi kambanoren e kishës së vjetër.....	47
Por ja që për fat të keq.....	48
I zoti i shtëpisë kthehet në Itakë.....	50
Mbase nuk kishte nevojë për to.....	52
Ishte një fluturim i papritur.....	53
Vetëm mjegullat ja zënin frymën.....	54
Kur mbetëm vetëm.....	55
I doja lulet kur qeshnin.....	56
Ose për fatin e gjelbërimit.....	57
Po ashtu edhe bora binte e përdredhur.....	58
Për të ua lënë nipërve amanetin.....	59
Se vetëm atëherë.....	60
Kurse nga këmishët tona.....	61
Në zbrazëtinë e zbrazët të korridorit.....	62
Ngrite zërin tënd prej bubullime.....	63

Gatuan me një dashuri të madhe.....	64
Afrohej dita e gjykimit.....	65
Andaj qeshnim një kohë të gjatë.....	66
Nuk u shëmbëllenin ushtarëve të çakërdisur.....	67
Ose nënat që i kishin grisur shamitë.....	68
Së pari mali ne zbuti kalin.....	69

Cikli i tretë

Mos më uroni udhë të mbarë.....	71
Frika.....	73
Dielli ka pak shpresë.....	74
Askush nuk e shkundi deri më sot.....	75
Nuk doli asnjë perëndi.....	76
Prekin plazmën e kohës.....	77
Nga gjaku i juaj i prishtë.....	78
Me një ushtri prej mishi e gjaku.....	79
Nga këto lindje Homeriane.....	80
Hijet e murrme si me një vello zie.....	81
Po ikin si djalli prej temjanit.....	82
Se do të shkojnë diku.....	83
Sërish edhe sonte.....	84
As që do të pushojnë ndonjëherë.....	85
Rriten edhe dhimbjet e plagëve.....	86
Dëgjoni gjëmën e kësaj toke.....	87
S'mund ta shkuli asnjë tufan.....	88
Mos më uroni udhë të mbarë.....	89
Dobiç na doli lahuta.....	90

